



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
**Ministria e Zhvillimit Ekonomik**  
**Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development**

BALANCA VJETORE E ENERGJISË  
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2015

GODIŠNJI ENERGETSKI BALANS  
REPUBLIKE KOSOVA ZA 2015. GODINU

ANNUAL ENERGY BALANCE OF  
REPUBLIC OF KOSOVO FOR THE YEAR 2015

Prishtinë, 2014



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
**Ministria e Zhvillimit Ekonomik**  
**Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development**

**BALANCA VJETORE E ENERGJISË**  
**E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2015**

**Prishtinë, Dhjetor 2014**

*Ky dokument është përgatitur nga Divizioni i Politikave të Energjisë në MZHE. Pa mbështetjen dhe bashkëpunimin e ngushtë me entitetet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për Rregullat për Balancat e Energjisë, ky dokument nuk do të mund të përgatitej.*

## Përmbajtja

### Shkurtesat

1. Hyrje.....	4
2. Furnizimi me produkte energjetike për periudhën 2012-2014.....	5
3. Konsumi final i energjisë për periudhën 2012-2014.....	6
3.1. Konsumi sipas llojeve të produkteve të energjisë.....	6
3.2. Konsumi i energjise sipas sektorëve të ekonomisë.....	7
3.2.1. Sektori i industrisë.....	9
3.2.2. Sektori i amvisërisë.....	9
3.2.3. Sektori i shërbimeve.....	10
3.2.4. Sektori i bujqësisë.....	10
3.2.5. Sektori i transportit.....	11
4. Parashikimi i kërkesës për energji për vitin 2015.....	12
4.1. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e amvisërisë.....	12
4.2. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e shërbimeve.....	13
4.3. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e industrisë.....	14
4.4. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e transportit.....	15
4.5. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e bujqësisë.....	15
4.6. Parashikimi i nevojave të përgjithshme (totale) për konsumin final të produkteve të energjisë për vitin 2015.....	16
5. Parashikimi i humbjeve të energjisë për vitin 2015.....	17
5.1. Humbjet e energjisë elektrike.....	17
5.2. Humbjet e ngrohjes qendrore.....	17
6. Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike për vitin 2015.....	17
6.1. Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike nga termocentralet.....	17
6.2. Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet dhe burimet e ripërtitshme.....	178
6.3. Parashikimi i importit të energjisë për vitin 2015.....	19
7. Parashikimi i emetimi të ndotësve nga termocentralet.....	20
7.1. Emetimet specifike të TC Kosova A.....	20
7.2. Emetimet specifike të TC Kosova B.....	20
8. Indikatorët e efijencës së energjisë së termocentraleve.....	21
Shtojca 1. Pasqyra e fuqive instaluese e TC Kosova (A+B) dhe SH.A. Kosova Thëngjilli.....	23
Shtojca 2. Pasqyra e fuqive instaluese e hidro-njësive prodhuese.....	23
Shtojca 3. Karakteristikat e burimeve energjetike dhe konvertimi i njësive.....	24
Shtojca 4. Projektet e parapara për vitin 2015.....	25
Shtojca 5. Balanca vjetore e energjisë për vitin 2015.....	29

**Shkurtesat**

MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
KOSTT sh.a	Operatori i Sistemit dhe Tregut
KEK	Korporata Energjetike e kosoves
KEDS	Kompania per distribuim dhe furnizim me energji elektrik
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
MF	Ministria e Financave
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
APK	Agjensioni Pyjor i Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë
SKE	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
REKOS	Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011
CRES	Qendra për burime të ripërtritshme dhe kursimin e energjisë, Athine-Greqi
EUROSTAT	Enti i Statistikave i Komunitetit Evropian
IEA	Agjencioni Ndërkombëtar i Energjisë
GLN	Gazi i Lëngëzuar i Naftës
TC	Termocentral
HC	Hidrocentral
GWh	Giga Vat Orë
GW	Giga Vat
MWh	Mega Vat Orë
MW	Mega Vat
BRE	Burime të Ripërtritshme të Energjisë
BPV	Bruto Produkti Vendor

## 1. Hyrje

Dokumenti "Balanca Vjetore e Energjisë e Republikës së Kosovës për vitin 2015" është përgatitur duke u bazuar në nenin 5 të Ligjit për Energji Nr. 03/L-184 dhe Udhëzimin Administrativ "mbi Rregullat për Balancat e Energjisë", Nr.07/2011. Qëllimi i këtij dokumenti është të informojë të gjithë të interesuarit për parashikimin e kërkesës për energji për vitin 2015.

Dokumentet bazë për hartimin e këtij dokumenti kanë qenë:

- Balancat e Energjisë së Kosovës për vitet 2011, 2012 dhe 2013;
- Balanca e Energjisë Elektrike për vitin 2015, hartuar nga KOSTT-i;
- Balanca Elektroenergjetike 2015, hartuar nga KEK-u;
- Balanca vjetore 2014-2015, hartuar nga Ngrohtorja Termokos sh.a. Prishtinë;
- Balanca vjetore 2014-2015, hartuar nga Ngrohtorja e Qytetit sh.a. Gjakovë.
- Informacionet periodike mujore për vitin 2014 nga entitetet e përcaktuara në UA 2007/11 për raportimin e të dhënave të energjisë (Ndërmarrjet e energjisë, ASK etj).

Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në bazë të kërkesave të formatit EUROSTAT. Balanca e energjisë elektrike e hartuar nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) ka shërbyer për parashikimin e kërkesave për energji elektrike dhe mënyrën e mbulimit të tyre. Balancat vjetore të ngrohjeve të qytetit të Prishtinës dhe Gjakovës kanë shërbyer për parashikimin e kërkesave të ngrohjes si dhe mbulimin e tyre. Balancat vjetore të hartuara nga MZHE kanë shërbyer si bazë për të përcaktuar trendin e zhvillimit të kërkesave të burimeve tjera të energjisë (druri, produktet e naftës, energjia solare) për vitin 2014.

Pjesët themelore të balancës së energjisë sipas formatit të EUROSTAT-it janë:

- Pjesa e parë ka të bëjë me produktet energjetike primare, atyre të përfituara, importet, eksportet dhe stoqet për të gjitha produktet energjetike.
- Në pjesën e dytë paraqiten transformimet e produkteve primare në ato sekondare. Në këtë grup futen transformimet e energjisë në të gjitha centralet për transformim të produkteve të ndryshme energjetike në energji elektrike, impiantet për prodhimin e produkteve energjetike të patentuar dhe briketim, impiantet e gazifikimit, furnalatat, ngrohje qendrore, panele solare. Këtu përfshihen edhe shkëmbimet dhe transferet e produkteve energjetike.
- Në pjesën e tretë paraqiten humbjet e energjisë në shpërndarje dhe transmision (përfshirë të gjitha produktet energjetike).
- Në pjesën e katërt paraqitet shpenzimi vetanak nga dega e energjisë dhe konsumi i përgjithshëm final. Në shpenzimet e energjisë përfshihen të gjitha shpenzimet e lidhura me procesin e punës së impianteve energjetike.

- Pjesa e pestë lidhet me konsumin final të produkteve të energjisë. Në këtë grup përfshihet konsumi i të gjitha produkteve energjetike që shpenzohen nga pesë sektorët ekonomikë: amvisëria, industria, shërbimet, transporti dhe bujqësia.

Duhet theksuar se konsumi i energjisë në këtë dokument është parashikuar duke u bazuar në anketa për konsumin e energjisë të realizuara nga 2009 deri në 2014. Konsumi i energjisë është studiuar si nga ana sektoriale ekonomike (sektori i industrisë, amvisërisë, shërbimeve, transportit dhe bujqësisë) ashtu edhe nga ana e llojeve të produkteve të energjisë.

Si bazë kanë shërbyer anketat e realizuara në vitin 2009 për konsumin e vitit 2008 për të gjithë sektorët ekonomikë, anketa e realizuar në vitin 2011 për konsumin e biomasës për vitet 2010 dhe 2009 në sektorët e amvisërisë, shërbimeve dhe industrisë nga CRES-i e kontraktuar nga Komuniteti i Energjisë dhe anketa për konsumin e energjisë në sektorin e amvisërisë si dhe anketat e sektorit të industrisë të realizuar në 2010 (nga MPR Group) , atij të amvisërisë në 2011 (nga INTECH), te shërbimeve 2012 (nga Studio Links 4) dhe të bujqësisë të realizuar në vitin 2013 (nga InTECH).

## **2. Furnizimi me produkte energjetike për periudhën 2012- 2014**

Parashikimi i konsumit të energjisë për vitin vijues (2015) bazohet në trendin e tri viteve të fundit para vitit për të cilin bëhet parashikimi. Të dhënat e vitit 2014 bazohen mbi bazën e rritjes së zhvillimi ekonomik të Kosovës për vitin 2014 krahasuar me vitin 2013.

Në Tabelën 1 paraqiten të dhënat për sasinë e produkteve primare të energjisë për vitet 2012, 2013 dhe 2014.

*Tabela 1. Pasqyra e sasisë së energjisë së produkteve primare në dispozicion gjatë periudhës 2012-2014 (ktoe)*

	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>
Thëngjill	1528.10	1552.16	1524.30
Produkte nafte	560.65	579.32	606.87
Biomasë	247.49	247.65	251.66
Energji elektrike	13.09	-28.82	48.74
Hidroenergji	8.22	12.32	11.04
Energji solare	0.69	0.76	0.53
<b>Totali</b>	<b>2358.24</b>	<b>2363.39</b>	<b>2443.13</b>

*Burimi: dokumentet e MZHE të balancave të energjisë*




Figura 1. Pasqyra e sasisë së energjisë së burimeve primare në dispozicion gjatë periudhës 2012-2014 (ktoe)

Energjia elektrike e importuar konsiderohet si produkt primar energjetik me që transformimi i kësaj energjie nuk ka ndodhur në vendin tonë por jashtë tij.

Siç vërehet nga Tabela 1 dhe diagrami në Figurën 1, sasia e përgjithshme(bruto) e energjisë në dispozicion në vitin 2014 është 2443.13 ktoe ndërsa në vitin 2013 ka qenë **2363.39** ktoe. Pra, në vitin 2014 ka një rritje të sasisë së energjisë në dispozicion në masën prej 3.4 %. Duhet të theksuar se një rritje e tillë e produkteve primare të energjisë është shaktuar si pasojë e nevojës së importit të energjisë elektrike në masë të madhe për shkak të avarisë në “TC Kosova A” me 06 qershor 2014.

### 3. Konsumi final i energjisë për periudhën 2012-2014

Në vazhdim do të paraqiten të dhëna për sasinë e konsumuar të produkteve energjetike të ndryshme përgjatë periudhës 2012-2014. Kjo bëhet me qëllim që të paraqitet baza mbështetëse e analizave të parashikimit të kërkesave për energji për vitin 2015.

Konsumi për vitin 2012 dhe 2013 është bazuar në hulumtimin me anketa të realizuara përgjatë periudhës 2009,2010, 2011, 2012 dhe 2013.

#### 3.1. Konsumi sipas llojeve të produkteve energjetike

Në vijim, në Tabelën 2 paraqitet konsumi i të gjitha produkteve energjetik për periudhën 2012-2014 për qëllime energjetike dhe jo-energjetike:



Tabela 2. Pasqyra e konsumit të të gjitha produkteve energjetike (ktoe) për periudhën 2012-2014

	2012	2013	2014
Thëngjill	68.17	55.95	59.2
Produkte naftë	561.18	573.58	589.07
Biomasë	247.5	247.65	251.66
Energji elektrike	384.54	399.57	416.43
Energji solare	0.69	0.76	0.53
Ngrohje e përfitur	3.44	3.67	8.01
<b>Gjithsej</b>	<b>1265.52</b>	<b>1281.18</b>	<b>1324.9</b>

Burimi: dokumentet e MZHE të balancave të energjisë

Nga Tab.2 shihet se produktet e naftës paraqesin produktin energjetik që është konsumuar në sasinë më të madhe, që në tërësinë e sasisë së konsumit merr pjesë me 44.5%. Energjia elektrike zë vendin e dytë të pjesëmarrjes me 31.4%, biomasa merr pjesë me 19%, thëngjilli merr pjesë me 4.5%, ngrohja e përfitur merr pjesë 0.6% dhe energjia solare merr pjesë me vetëm 0.04%.

Në figurën 2 është bërë paraqitja grafike e trendit të konsumit të energjisë sipas llojeve të produkteve energjetike për periudhën 2012-2014.




Figura 2. Pasqyra e konsumit të produkteve të energjisë në të gjithë sektorët për periudhën 2012-2014 (ktoe)

### 3.2. Konsumi i energjisë sipas sektorëve të ekonomisë

Në Tabelën 3 paraqitet gjendja e konsumit të sektorëve për qëllime energjetike. Siç shihet sektori i amvisërisë është sektori që ka konsumuar më së shumti energji përgjatë të tri viteve të fundit. Ky sektor pasohet nga sektori i transportit. Sektori i industrisë është

sektori i tretë për nga konsumi i energjisë duke u pasuar nga ai i shërbimeve. Kurse sektori i bujqësisë është sektori që ka konsumuar vazhdimisht më së paku energji.

Tabela 3. Pasqyra e pjesëmarrjes se burimeve te energjisë për qëllime energjetike tek të gjithë sektorët (ktoe)

	2012	2013	2014
Sektori i industrisë	272.98	266.63	282.35
Sektori i amvisërisë	473.73	495.52	517.98
Sektori i shërbimeve	117.09	118.79	116.34
Sektori i bujqësisë	19.85	29.34	29.85
Sektori i transportit	342.65	328.52	332.24
<b>Gjithsej</b>	<b>1226.3</b>	<b>1238.8</b>	<b>1278.76</b>

Burimi: Balancat e energjisë hartuar nga MZHE




Figura 3. Pasqyra e konsumit të produkteve energjetike sipas sektorëve për periudhën 2012-2014 (ktoe)

Konsumi final për përdorim jo energjetik për vitin 2014 ka qenë 46.13 ktoe. Torfa është lloj i vetëm i thëngjillit i cili është konsumuar për qëllime jo energjetike dhe atë në sektorin e industrisë kimike në sasi prej 0.46 ktoe. Ndërsa prej nën-produkteve të naftës, bitumeni ( i cili shfrytëzohet në masën dërmuese në shtruarjen e rrugëve-trajtohet si industri ndërtimore) është konsumuar në sasi prej 41.05 ktoe kurse lubrifikantet e shfrytëzuara në industrinë kimike janë në sasi prej 4.63 ktoe.

Në tabelën 4 është paraqitur gjendja e konsumit final për përdorime jo energjetike për periudhën 2012-2014

Tabela 4. Konsumi final jo-energjetik sipas nën-sektorëve industrial (ktoe)

Sektorët ekonomikë	2012	2013	2014
Industria kimike	0.4	0.44	0.46
Industritë tjera	41.58	41.93	45.67
<b>Gjithsej</b>	<b>41.98</b>	<b>42.37</b>	<b>46.13</b>

### 3.2.1. Sektori i industrisë

Produktet e naftës, në sektorin e industrisë, zënë pjesën më të madhe të produkteve të energjisë me një pjesëmarrje prej 52.3% ku 38.4% e tyre konsumohet për qëllime energjetike kurse 13.9% për qëllime jo-energjetike, pasuar nga energjia elektrike me një pjesëmarrje prej 33.8%, thëngjilli me një pjesëmarrje prej 10.3%, ku 10.1% konsumohet për qëllime energjetike, biomasa me një pjesëmarrje prej 3.6% që njëherë është burimi më pak i konsumuar.




Figura 4. Pasqyra e konsumit të produkteve energjetike në sektorin e industrisë për periudhën 2012-2014 (ktoe)

### 3.2.2. Sektori i amvisërisë

Energjia elektrike është produkti më i konsumuar i energjisë me një pjesëmarrje prej 47.2% të totalit të konsumit të energjisë, pasuar nga biomasa me një pjesëmarrje prej 44.9%, thëngjilli me një pjesëmarrje prej 3.5%, produktet e naftës me një pjesëmarrje prej 3.3%, ngrohja e përfitur me 1% dhe energjia solare me 0.03%.




Figura 5. Pasqyra e konsumit të produkteve energjetike në sektorin e amvisërisë për periudhën 2012-2014 (ktoe)

### 3.2.3. Sektori i shërbimeve

Energjia elektrike është burimi më i preferuar i energjisë së konsumuar në sektorin e shërbimeve me një pjesëmarrje prej 51.1% të totalit të energjisë, pasuar nga produktet e naftës me një pjesëmarrje prej 34.6%, biomasa me një pjesëmarrje prej 6.1%, thëngjilli 5.5%, ngrohja e përfitur me një pjesëmarrje prej 2.4% dhe energjia solare me një pjesëmarrje prej 0.3%.




Figura 6. Pasqyra e konsumit të produkteve të energjisë në sektorin e shërbimeve për periudhën 2012-2014 (ktoe)

### 3.2.4. Sektori i bujqësisë

Në sektorin e bujqësisë, nafta dhe produktet e saj zënë vendin kryesor në konsumin e përgjithshëm të sektorit me një pjesëmarrje prej 92.8% të totalit të konsumit të energjisë,

pasuar nga energjia elektrike me një pjesëmarrje prej 4.2%, thëngjilli merr pjesë me 2.1% dhe biomasa me një pjesëmarrje prej 0.8 %.




Figura 7. Pasqyra e konsumit të burimeve të energjisë në sektorin e bujqësisë për periudhën 2012-2014 (ktoe)

### 3.2.5. Sektori i transportit

Në sektorin e transportit konsumohen vetëm produkte të naftës. Nafta është produkti energjetik më i konsumuar në këtë sektor me një pjesëmarrje prej 74.1% nga totali i energjisë, pasuar nga benzina me 18.0%, kerozina me 4.6% dhe GLN - ja 3.2%.




Figura 8. Pasqyra e konsumit të derivateve të naftës në sektorin e transportit për periudhën 2012-2014 (ktoe)

#### 4. Parashikimi i kërkesës për energji për vitin 2015

Parashikimi i kërkesës për energji në të gjithë sektorët është bërë duke u bazuar në:

- pasqyrën energjetike të periudhës 2012-2014 (duke pasur parasysh konsumin e parashikuar të energjisë për vitin 2014 mbi bazën e rritjes së zhvillimi ekonomik të Kosovës për vitin 2014 krahasuar me vitin 2013;
- të dhënat për rritjen ekonomike me 4.3%<sup>1</sup> të BPV-së për vitin 2015 ;
- rritjen rreth 1 % të shkallën së numrit të amvisërive;
- Balancën e energjisë elektrike për vitin 2015 të hartuar nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut ku janë pasqyruar të dhënat për prodhimin, importin, eksportin, humbjet në bartje, humbjet në distribucion, prodhimin e thëngjillit dhe mazutit si dhe emetimin e ndotësve në mjedis,
- Te dhenat per parashikimin e energjise per ngrohje per sezonin 2014/2015 nga ngrohtoret "TERMOKOS" dhe ngrohtorja e qytetit te Gjakovës.

Pra, për parashikimi të rritjes së konsumit të energjisë në Kosovë për vitin 2015 është marrë parasysh rritja e llogaritur e zhvillimit ekonomik në këtë vit që është llogaritur të jetë 4.3%.

Figura më poshtë paraqet rritjet ekonomike prej vitit 2012-2013, dhe parashikimin për vitet 2014 dhe 2015.




Figura 9. Trendi i rritjes ekonomike në Kosovë për periudhë 2012-2015

##### 4.1. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e amvisërisë

Numri i popullsisë është faktor i rëndësishëm për llogaritjen e kërkesës për energji në sektorin e amvisërisë.

Kërkesat për energji, në sektorin e konsumit të amvisërive, janë më shumë në varësi të drejtpërdrejt me numrin e amvisërive (ku një amvisëri mund të ketë më shumë se një familje) sidomos kur kemi të bëjmë me konsumin e drurit për zjarr, se sa me numrin e

<sup>1</sup> Bazuar në parashikimin e rritjes ekonomike për vitet 2013 dhe 2014 nga Ministria e Financave

popullësisë. Prandaj vlerësimi më i drejt i numrit të familjeve paraqet interes themelor në parashikimet e konsumit të energjisë në sektorin e amvisërisë.

Tabela 5: Parashikimi i konsumit të energjisë në sektorin e amvisërisë për vitin 2015 (në ktoe)

Thëngjill	Produkte naftë	Biomasë	Energji elektrike	Energji solare	Ngrohje e përfituar	Gjithsej
18.46	17.61	233.93	256.84	0.21	5.98	533.03

Gjatë vitit 2015 parashihet të kemi një rritje të konsumit të energjisë në përgjithësi rreth 2.9% në krahasim me vitin 2014.

Në vitin 2015 pritet rritje e konsumit të thëngjillit nga 18.35 ktoe në 18.46 ktoe, po ashtu pritet rritje e konsumit të biomasës nga 232.53 ktoe në 233.93 ktoe, të produkteve të naftës nga 17.14 ktoe në 17.61 ktoe dhe ngrohja e përfituar nga 5.21 ktoe në 5.98 ktoe ndërsa konsumi i energjisë elektrike nga 244.59 ktoe në 256.84 ktoe.




Figura 10. Pjesëmarrja e të gjitha produkteve energjetike në sektorin e amvisërisë

#### 4.2. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e shërbimeve

Në vijim paraqitet parashikimi i konsumit të burimeve të energjisë në sektorin e shërbimeve:

Tabela 6: Parashikimi i konsumit të energjisë në sektorin e shërbimeve (në ktoe)

Thëngjill	Produkte naftë	Biomasë	Energji elektrike	Energji solare	Ngrohje e përfituar	Gjithsej
6.72	42.46	7.16	70.77	0.50	3.22	130.83

Kërkesa për energji elektrike në sektorin e shërbimeve për vitin 2015 parashihet të rritet nga 59.45 ktoe sa ishte në vitin 2014 në 70.77 ktoe në 2015. Konsumi i ngrohjes parashihet të rritet nga 2.80 ktoe në vitin 2014 në 3.22 ktoe në vitin 2015, thëngjilli rritet nga 6.45 ktoe

në 6.72 ktoe, produktet e naftës nga 40.23 ktoe në 42.46 ktoe dhe konsumi i druve të zjarrit do të rritet nga 7.05 ktoe në 7.16 ktoe.




Figura 11. Pjesëmarrja e të gjitha produkteve të energjisë në sektorin e shërbimeve

#### 4.3. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e industrisë

Në vijim paraqitet parashikimi i konsumit të burimeve të energjisë në sektorin e industrisë:

Tabela 7. Parashikimi i konsumit të burimeve të energjisë në sektorin e industrisë (ktoe)

	Thëngjill	Produkte Naftë	Biomasë	Energji Elektrike	Gjithsej
Konsumi final i përgjithshëm i energjisë	35.23	199.56	14.09	121.70	370.57
Konsumi final për qëllime energjetike	34.75	149.79	14.09	121.70	320.33
Konsumi final për qëllime jo-energjetike	0.48	49.77	0.00	0.00	50.24

Konsumi i energjisë për qëllime energjetike dhe jo-energjetike, në total, në sektorin e industrisë parashihet që për vitin 2015 të jetë 370.57 ktoe. Energjia elektrike në sektorin industrial parashihet të ketë rritje nga 111.12 ktoe në vitin 2014 në 121.70 ktoe në vitin 2015, thëngjilli për qëllime energjetike nga 33.31 ktoe në 34.75 ktoe ndërsa për qëllime jo energjetike nga 0.46 ktoe në 0.48 ktoe, produktet e naftës për qëllime energjetike, parashihet të rriten nga 126.08 ktoe në 149.79 ktoe ndërsa për qëllime jo energjetike parashihet një rritje nga 45.67 ktoe në 49.77 ktoe, biomasa nga 11.83 ktoe në 14.09 ktoe.



#### 4.4. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e transportit

Tabela 8: Parashikimi i konsumit të produkteve energjetike në sektorin e transportit (ktoe)

Naftë	Benzinë	Kerozinë	GLN	Gjithsej
255.16	57.99	16.10	11.19	340.44

Sektorin e transportit karakterizohet me konsumin e derivateve të naftës. Në sektorin e transportit për vitin 2015 parashihet një rritje e konsumit të energjisë për 2.5% nga konsumi i vitit 2014. Konsumi i derivateve të naftës parashihet të rritet në hap me rritjen ekonomike të parashikuar për vitin 2015. Pra, në total konsumi i produkteve të energjisë në sektorin e transportit parashihet të rritet nga 332.24 ktoe në vitin 2014 në 340.44 ktoe në vitin 2015.




Figura 13. Pjesëmarrja e të gjitha produkteve të energjisë në sektorin e transportit

#### 4.5. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e bujqësisë

Në vijim paraqitet kërkesa e konsumit të produkteve energjetike në sektorin e bujqësisë: Për vitin 2015 konsumi i sektorit të bujqësisë parashihet të jetë 31.19 ktoe ose një rritje prej 4.5% krahasuar me vitin 2014.

Siç shihet në tabelën dhe grafikun në vijim nafta dhe produktet e saj paraqesin produktin energjetik që përdoret më së shumti në sektorin e bujqësisë me një sasi prej 28.54 ktoe ose 91.5% të konsumit total, pasuar nga energjia elektrike me 1.43 ktoe ose 4.6%, thëngjilli me 0.66 ktoe ose 2.1% dhe biomasa me 0.56 ktoe ose 1.8%

Tabela 9. Parashikimi i konsumit të produkteve energjetike në sektorin e bujqësisë (ktoe)

Thëngjill	Produkte nafte	Biomasë	Energji elektrike	Gjithsej
0.66	28.54	0.56	1.43	31.19




Figura 14. Pjesëmarrja e te gjitha produkteve te energjisë ne sektorin e bujqësisë

#### 4.6. Parashikimi i nevojave të përgjithshme (totale) për konsumin final të produkteve energjetike për vitin 2014

Në vijim paraqitet parashikimi i konsumit të të gjitha produkteve energjetike për vitin 2015:

Tabela 10. Pasqyra e parashikimit të konsumit të të gjitha produkteve energjetike për vitin 2015 (ktoe)

Thëngjill	Produkte nafte	Biomasë	Energji elektrike	Ngrohje e përfituar	Energji solare	Gjithsej
61.07	628.61	255.73	450.74	9.21	0.71	1406.06

Nga të dhënat e grumbulluara dhe analizat del se nafta dhe produktet e saj do të vazhdojnë të jenë pjesëmarrësit më të mëdhenj në konsumin total të produkteve energjetike për qëllime energjetike dhe jo-energjetike, me 44.7% ose 628.61 ktoe, energjia elektrike merr pjesë me 32.1% ose 450.74 ktoe, biomasa merr pjesë me 18.2% ose 255.73 ktoe ndërsa thëngjilli merr pjesë me 4.3% ose 61.07 ktoe, ngrohja e përfituar 0.7% ose 9.21 ktoe, kurse energjia solare merr pjese me një pjesëmarrje 0.1% në konsum të energjisë respektivisht 0.71 ktoe.




Figura 15. Pjesëmarrja e te gjitha produkteve energjetike në konsumin total të energjisë

## 5. Parashikimi i humbjeve të energjisë për vitin 2015

### 5.1. Humbjet e energjisë elektrike

Humbjet e energjisë elektrike ndahen në:

- Humbjet në rrjetin e transmisionit, që paraqesin diferencën e vlerave të matura të energjisë elektrike në hyrje të transmisionit dhe atyre të matura në dalje të rrjetit transmetues. Këtu përfshihen edhe humbjet për shkak të transitit (pikat matëse në linjat interkonektive 400,220 dhe 110kV transferohen në kufijtë ndarës duke përdorur koeficientet e aprovuar të transferimit).
- Humbjet në rrjetin e shpërndarjes (distribucionit), që janë diferenca e vlerave të matura të energjisë elektrike së pranuar në pikat e ndarjes nga rrjeti i transmisionit dhe hyrjet nga gjeneratorët e kyçur në shpërndarje dhe në anën tjetër vlerave të matura të energjisë elektrike të dërguar konsumatorëve.

Në planifikimin e humbjeve të tëra në rrjetin e transmisionit përfshihen humbjet e shkaktuara nga ngarkesa e konsumit të Kosovës dhe humbjet e shkaktuara nga energjia elektrike që kalon si tranzit.

Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmisionit janë planifikuar të jenë 1,8% të sasisë së gjithmbarshme të energjisë në dispozicion (tabela në paragrafin 4.8) (Prodhimi në prag të transmisionit dhe importi i planifikuar) ose **114 GWh**.

Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes janë planifikuar të jenë **1 275 GWh** ose **26,6%** e kërkesës totale të distribucionit. Këtu bëjnë pjesë: humbjet teknike, humbjet komerciale dhe energjia e pa faturuar e Veriut të Kosovës.

### 5.2. Humbjet e ngrohjes qendrore

Humbjet e ngrohjes qendrore në rrjetin e bartjes dhe shpërndarjes do të jenë **25,185 MWh**.

## 6. Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike për vitin 2015

### 6.1. Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike nga termocentralet

Prodhimi vjetor i energjisë elektrike në TC planifikohet deri në vlerën e shfrytëzimit optimal të kapaciteteve prodhuese.

Energjia elektrike e dhënë në prag të transmisionit nga TC Kosova A dhe TC Kosova B planifikohet të jetë: **5 760 GWh**, ku:

- TC Kosova A = **1 927 GWh**, në prag të transmisionit.
- TC Kosova B = **3 833 GWh**, në prag të transmisionit.

## 6.2. Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet dhe burimet e ripërtrishme

Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga HC Ujmani planifikohet:

- HC Ujmani = **84 GWh**.

Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga hidrocentralet dhe burimet e energjisë nga era të kyçura në sistemin e shpërndarjes planifikohet:

- HC Lumbardhi = **26,5 GWh**
- HC (Radavci, Istogu, Dikanci) = **17,5 GWh**
- dhe gjeneratorët me erë = **2,5GWh**

Energjia elektrike e gjithmbarshme në prag të transmisionit e prodhuar nga TC Kosova A, TC Kosova B dhe HC Ujmani për vitin 2015, është planifikuar të jetë **5 844 GWh**.

Ndërsa, prodhimi i tërë nacional, duke përfshirë edhe HC Distributive dhe gjeneratorët me erë, planifikohet të jetë **5 890 GWh**.

Tabela 11: Parashikimi i prodhimit, importit, konsumit dhe humbjeve në bartje në sistemin elektroenergetik

	MWh	Gjithësejt	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	Kosova A - Prodhimi në prag të transmisionit	1,927,016	180,106	162,735	157,474	151,795	156,666	149,464	155,124	155,124	149,404	154,424	174,465	180,235
2	Kosova B - Prodhimi në prag të transmisionit	3,833,085	375,015	337,537	377,986	189,440	300,029	370,678	366,541	154,564	297,707	378,911	312,638	372,039
3	Ujmani	84,000	9,000	8,000	8,000	8,000	7,000	6,000	4,000	4,000	6,000	7,000	8,000	9,000
4	HC Distributive	46,595	2,396	1,979	2,974	6,625	8,880	6,601	2,968	1,483	1,308	3,211	4,110	4,060
5	(1+2+3+4) Prodhimi Nacional	5,890,696	566,517	510,251	546,434	355,860	472,575	532,743	528,633	315,171	454,419	543,546	499,213	565,334
6	(1+2+3) Prodhimi (hyrja në transmision)	5,844,101	564,121	508,272	543,460	349,235	463,695	526,142	525,665	313,688	453,111	540,335	495,103	561,274
7	Importi	507,960	83,300	51,300	23,300	108,240	17,920	0	3,450	98,090	6,720	0	35,250	80,390
8	(6+7) Energjia në disponim	6,352,061	647,421	559,572	566,760	457,475	481,615	526,142	529,115	411,778	459,831	540,335	530,353	641,664
9	Trepça	25,850	2,466	2,158	2,331	2,035	2,214	2,001	1,970	1,816	1,967	2,121	2,114	2,657
10	Sharrceci sh.a	65,750	800	3,000	6,600	6,300	6,500	6,450	6,400	6,500	6,600	6,200	5,500	4,900
11	NewCo Ferronikeli sh.a	631,978	53,675	48,481	53,675	51,943	53,675	51,943	53,675	53,675	51,943	53,675	51,943	53,675
12	Mihjet	138,000	12,000	12,000	12,000	11,000	11,000	11,000	11,000	11,000	11,000	12,000	12,000	12,000
13	Shpenzimet e TC nga transmisioni	134,093	14,515	13,162	14,510	9,432	10,843	11,370	7,233	7,233	6,920	10,033	14,207	14,635
14	Kërkesa e Distribucionit	4,742,845	543,752	471,223	452,148	384,066	351,824	297,128	323,495	320,376	321,168	344,828	391,953	540,883
